



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1944/ 1 prot

Datë 21.07.2025

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË
TJERË**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-49235-05-27-2025 me objekt “Evadim, trajtim dhe asgjesim i mbetjeve të rrezikshme spitalore në S.U.O.Gj Mbretëresha Geraldinë Tiranë”, me fond limit 18,300,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 27-06-2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “MEDI - TEL” SHPK në procedurën e mësipërme e prokurimit.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK , NIPT L28029301Q, Adresa: *Fshatin Gurez, afër ish-Kanalit të Acidit.*
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
Adresa: *Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)..*
- Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “MEDI - TEL” SHPK NIPT M12406021M
Adresa: *Kruje, Nikel, Qereke, rruga Nacionale Tirane – Fushe Kruje, km 13, ndertese private 1 kateshe, zona kadastrale 3096, me nr.pasurie 97/30.*

Në datën 19.07.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5582 dhe numër prot.1944/2025, datë 21.07.2025 e operatorit ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-49235-05-27-2025 me objekt “Evadim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore në S.U.O.Gj Mbretëresha Geraldinë Tiranë”, me fond limit 18,300,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 27-06-2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitura nga operatori ekonomik “MEDI - TEL” SHPK, në procedurën e mësipërme e prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 3 shkronja “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK kundërshton me anë të ankesës më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Operatori Ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” sh.p.k, me Nuis L28029301Q nuk plotëson kërkesat e LPP sipas Nenit 76 pika 3 të LPP si dhe pikën 2.1.4 Seksioni 2.1 “Kapaciteti profesional të operatorëve ekonomikë ”Kërkesat e Veçanta për Kualifikim”(KVK) për këto arsye: Në pikën 2.1.4 të KVK, në dokumentat e tenderit është kërkuar: 2.1.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë: b. Vërtetim që operatori nuk ka masë administrative në fuqi nga strukturat inspektuese të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në zbatim të Ligj Nr.10433 date 16.06.2011 “Per Inspektimin ne Republiken e Shqiperise”, Ligjit “Për Lejet e Mjedisit” Nr.10448 date 14.07.2011 si dhe LIGJ Nr.10463, datë 22.9.2011 “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”. Për këtë pikë Operatori ka paraqitur shkresën Nr.6140/1 prot datë 09.06.2025 lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ku kjo e fundit referon se me Vendim të Komisionit të Apelit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin “V.A.L.E. RECYCLING” sh.p.k, është lënë në fuqi masa administrative sipas Vendimit Përfundimtar të Inspektimit të AKM “Nr.AKMDQ-2023-00535”, gjobë dhe dënim plotësues pezullim i lejes mjedisore. Ndaj vendimit të pezullimit të lejes mjedisore miratuar nga AKM dhe miratuar nga Ministri i Mjedisit, subjekti ofertues ka kërkuar në Gjykatën Administrative shfuqizimin e masave administrative të Komisionit të Inspektimit të AKM, por këto masa janë në fuqi deri në përfundimin e gjykimit nga Gjykata. Për sa më sipër, KVO arsyeton se referuar pikës 2.1.4 në Kërkesat e Veçanta për

Kualifikim, ku në mënyrë të qartë është vendosur si kusht për kualifikim, se ofertuesi nuk duhet të këtë masa administrative në fuqi, subjekti V.A.L.E. RECYCLING” sh.p.k, me Nuis L28029301Q, nuk e përmbush kërkesën për kualifikim pasi rezulton me masë administrative në fuqi me Vendim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Gjithashtu KVO vlerëson se fakti që masa administrative është ankimuar në gjykatë nga ofertuesi dhe as akti i Gjykatës Administrative për pezullimin e zbatimit të Vendimit të Ministrit të Mjedisit për pezullimin e lejes së mjedisit të subjektit V.A.L.E. RECYCLING” sh.p.k, nuk e ndryshojnë situatën juridike të ofertuesit për këtë procedurë, pasi Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresën Nr.6140/1 prot datë 09.06.2025 shprehet qartë se masa administrative është në fuqi. Në këto kushte përderisa ofertuesi nuk paraqiti një vendim gjyqsor të formës së prerë që të ketë shfuqizuar masën administrative në fuqi, KVO konstaton se subjekti V.A.L.E. RECYCLING” sh.p.k, me Nuis L28029301Q në momentin e zhvillimit të procedurës, është vlerësuar me shkelje të legjislacionit mjedisor nga organet shtetërore kompetente dhe është subjekt i dispozitave të skualifikimit në procedurën e prokurimit sipas nenit 76, pika 3 të LPP ku përcaktohet :3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;”

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “MEDI - TEL” SHPK” SHPK nuk i përmbush.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushjen e kriterëve si më poshtë vijon:

“2.3.4. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, apo nëpërmjet çdo mënyre posedimi të njohur nga ligji, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt prokurimi, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të VKM-se për miratimin e rregullores “Për menaxhimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, si më poshtë:

- a. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope*
- b. Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1*
- c. Makineri për larjen e kontenierëve cope 1*

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentet e mëposhtme provuese:

- a. Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);*
- b. Të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;*
- c. Katalog ose skede teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;*
- d. Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.*

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e te dhënave konkrete për secilën pajisje (përfshirë edhe ato back up), nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST, duke përfshirë të dhënat si vijon: emërtimi i impiantit / përcaktimi si primar apo back up / modeli / rrymat e mbetjeve që trajton dhe/ose asgjeson / Leja dhe Licenca përkatëse ku janë të përfshirë (nga ato të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër.

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 21.07.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Florent Zguro